

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO  		
Oda e Infermierëve, mamëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komara medicinskih sestara, bakića i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV · ARCHIV · ARCHIVE		
Nr. Prot. Broj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Sh. str. No. page	Data: Datum: Date:
115	2	25.02.2019
PRISTINE · PRISTINA · PRISTINA		



MARRVESHJE E MIRËKUPITIMIT

E lidhur në Prishtinë, më **01.02.2019**, në mes:

- **ODA E INFIERMIERËVE TË KOSOVËS**, Rr. Holger Petersen, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, të cilën e përfaqëson **z. Naser Rrustemaj**, Kryetar i Odës së Infermierëve të Kosovës, dhe
- **INSTITUTI KOSOVAR PËR MENAXHIM** me nr. Biznesi 70692937, Rr. Qamil Hoxha, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, të cilën e përfaqëson **z. Arditi AJVAZI** me numër personal: 1174091982, në cilësinë e Koordinatorit për trajnime dhe vizita studimore kuadër të IKM-së.

Hyrje

Neni 1 – Qëllimi i Marrëveshjes

Trajnimi i mjekëve dhe infermierëve të mjekësisë familjare në 32 Komuna në nivel të Kosovës, i cili është projekt i kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e projektit Kosovo Health Project Nr.P147402 dhe implementohet nga Instituti Kosovar për Menaxhim.

Neni 2 – Detyrimet e KMI-së

INSTITUTI KOSOVAR PËR MENAXHIM do të organizojë trajnime në 5 module: Shëndet Publik, Shëndet Mendor, Smundje kronike, Emergjencia mjekësore dhe Shëndet riprodhues për të gjithë mjekët dhe infermierët e mjekësisë familjare të sektorit parësor shëndetësor në 32 Komuna në nivel të Kosovës. Trajnimet për mjekë dhe infermier janë pa pages.

Neni 3 – Detyrimet e OIK-ut

ODA E INFIERMIERËVE TË KOSOVËS duke u bazuar në ligjin Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Komisionit për Edukim të Vazhdushëm kuadër të OIK-ut, në bazë të prezentimit dhe aplikimit të IKM-së duhet të akreditojë programin e trajnimit në 5 modulet: Shëndet Publik, Shëndet Mendor, Smundje kronike, Emergjencia mjekësore dhe Shëndet riprodhues, sipas rekomandimeve të OIK-ët për koficientët.

Neni 4 – Parimet dhe Vlerat

Ofrimi i metodologjive, teknikave, zgjidhjeve të qëndrueshme dhe shkathtësive, specifike, praktike, cilësore, unike dhe kreative për përmirsim të vazhdueshëm cilësor ofrimi të shërbimeve që dotë mundëson plotësimin e nevojave të qytetarëve duke zvogëluar shpenzimet përmes parandalimit të smundjeve, promovimit shëndetësor dhe ngritjes së cilësisë.

Neni 5 – Parimet Operative

Programi i trajnimit është i dizajnuar të zgjasë 5 ditë pune nga e Hëna deri të Premtën, prej orës 09:00 deri në ora 15:00 dhe në vete do të ngërthejë pesë modulet e lartëcekura, të cilat do të trajtohen nga një modul për secilën ditë të trajnimit, ku dotë trajnohen rreth 1874 mjekë dhe infermierë të grupuara në maksimum 71 grupe me nga 25 - 30 pjesëmarrës nga dy kategoritë e mjekëve dhe infermierëve të mjekësisë familjare në 32 Komuna në nivel vendi.

Neni 6 – Politika e IKM-së

Instituti Kosovar për Menaxhim i ofron të gjithë klientëve individual dhe grupor një gamë të gjerë të shërbimeve të konsulencës, hulumtimeve & analizave, rekrutimit të resurseve njerëzore, mundësive të trajnimit/zhvillimit të vazhdueshëm të strukturuar dhe të kualifikimeve jo formale të dizajnuara për të përmirësuar performancën e tyre në çdo nivel të karrierës apo stad të zhvillimit të organizatave ku ata punojnë. Kosovo Management Institute aktualisht posedon me një grup prej mbi 15 ekspertë/trajner vendor dhe ndërkombëtar të Mjekësisë familjare të angazhuar në përputhshmëri me dinamikën e programeve të trajnimeve dhe projekteve të caktuara.

Neni 7 – Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kohëzgjatja e marrëveshjes parashihet të jetë një vjeqare nga **01.02.2019 deri me 31.10.2019.**



Neni 8 – Hyrja në fuqi

Marrëveshja hynë në fuqi nga momenti që dy palët pajtohen me kushtet e marrëveshjes dhe nënshkruajnë atë.

PALËT KONTRAKTUESE I KUPTOJNË DHE PAJTOHEN T’I NËNSHTROHEN KUSHTEVE DHE RRETHANAVE NË KËTË MARRVESHJE


Naser RRUSTEMAJ
Kryetar i OIK

20.02.2019
Data


Ardit AJVAZI
IKM - Prishtinë

25.02.2019
Data